



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCAVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Njësia Org. Org. Jeshmice Org. Unit	AQP
Nr. / Faqjeve Br. Stranica No. Pages	1/25
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	13/25
Data : Datum : Date :	30.01 2025
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Qeveria –Vlada-Government**  
**Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, rada i**  
**transfera – Ministry of Finance, Labor and Transfers**  
**AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**  
**CENTRALNA AGENCIA NABAVKE/ CENTRAL PROCUREMENT AGENCY**

**KONTRATË PUBLIKE**

**TITULLI I KONTRATËS:**

**VETURA ME QERA PËR NEVOJAT E INSTITUCIONEVE TË**  
**KOSOVËS- RITENDER - LOT 3**

**NUMRI I PROKURIMIT: UA/2016-24-12248-2-1-1**

**NUMRI I KONTRATËS: UA/2016-24-12248-2-1-1/C640**

# **DRAFT KONTRATA<sup>1</sup> & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA**

## **PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA**

**Agjencia Qendrore e Prokurimit**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëjërën anë; dhe

**Auto Mita SH.P.K.** (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Vetura me qera për nevojat e institucioneve të Kosovës- Ritender - Lot 3 me numër identifikues: UA/2016-24-12248-2-1-1/C640**

### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Ofrimi i veturave me qera për nevojat e institucioneve të Kosovës për periudhën 60 mujore, sipas kushteve të paraqitura në Aneksin 1.

Autoriteti Kontraktues - AQP prokuron në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese.

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike është obliguese për Autoritetet Kontraktuese sipas Aneksit 7. Gjatë implementimit të kontratës mund të ndryshohen autoritete apo numri i veturave tek autoritetet nëse autoritetet e përfshira në Aneksin 7 për arsye të ndryshme objektive nuk mund të shfrytëzojnë këtë kontratë tërësisht apo pjesërisht dhe në rast se ka kërkesa në AQP nga autoritete tjera për shfrytëzimin e kësaj kontrate atëherë mund të lejohet ndryshimi i shfrytëzuesve të veturave vetëm me aprovimin e AQP-së.

1.2 Kontrata hyn në fuqi me datën 31.01.2025 dhe përfundon me datën 10.05.2030.

Afati i qiramarrjes llogaritet 5 vjet apo 60 muaj nga data e pranimit të automjetit. Afati i liferimit është 100 ditë. Nga data e pranimit të veturës (brenda 100 ditëve) do të fillojë llogaritja e kohëzgjatjes së qerasë 60 muaj. Nëse vonohet liferimi më shumë se 100 ditë do të vendosen penaltitë nga institucionet ndërsa llogaritja e kohëzgjatjes së qerasë do të fillojë që nga dita e 101, kjo për arsye se kontrata do të jetë valide për 63 muaj e 10 ditë dhe me rastin e përfundimit të kontratës do të përfundojë edhe qiramarrja e të gjitha veturave.

### **Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 1,107,000.00 €, për 50 vetura për 60 muaj apo 369€/veturë/muaj; një milion e njëqindeshtatë mijë Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai është i prerë dhe nuk i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

---

<sup>1</sup> Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Aneksi 1 – Specifikimet Teknike të detyrueshme;
- (e) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (f) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	<i>Emine Masurica</i>	Emri:	Behxhet Rrukiqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>30/01/2025</i>	Data:	<i>30.01.2024</i>
Vula:		Vula:	

**Për Ofruesin e Shërbimeve**

Emri:	<i>ALBAN MULLIQI</i>
Pozita:	<i>KOORDINATOR</i>
Nënshkrimi:	
Data:	<i>30/01/2024</i>
Vula:	

## PJESA II E KONTRATES    KUSHTET E PËRGJITHSHME

### **Neni 1**                    **Përkufizimet**

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofrues i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### **Neni 2**    **Ligji i aplikueshëm dhe gjuha**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3**                    **Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### **Neni 4**                    **Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e

propozuar duhet te përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### **Neni 8 Forca madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk

do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### **Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshtrojë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

## **Neni 10                   Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## **Neni 11                   Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

## **Neni 12                   Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13                   Dëmet e likuiduara**

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatuar pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

#### **Neni 14 Siguria e ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

#### **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### **Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17 Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### **Neni 18 Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.



18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### **Neni 22 Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

### PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : Gjuha Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës: Afati maksimal për dorëzimit të automjeteve është 100 ditë nga nënshkrimi i kontratës, ndërsa kontrata e qirasë është 60 muaj nga data e pranimit të automjetit. (Kontraktuesi mundet të fillojë me implementim të kontratës kur do që është i gatshëm (edhe pjesërisht) por jo me vonë se 100 ditë pas nënshkrimit të kontratës).
	6.4	Vendi i për formimit të shërbimeve është: Pranimi si dhe servisimi/rregullimi i automjeteve bëhet në objektin/adresën e kontraktuesit
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11	Kontraktuesi është i obliguar ti përmbush të gjitha kërkesat e paraqitura në Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Secili Institucion që shfrytëzon këtë kontratë do të caktoj Menaxheri e kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 110,700€ me validitet deri me 10.06.2030.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Faturat kontraktuesi duhet të dorëzojë tek secili AK që shfrytëzon kontratën faturat për muajin paraprak.  Pagesat duhet të bëhet sa më parë që të jetë e mundur pas pranimit të faturës por jo më shumë se që paraqitet tek neni 16 pika 3 e kushteve të përgjithshme të kontratës nga secili AK për veturat që shfrytëzon.  Kërkesat për pagese do të bëhet vetëm për Shfrytëzimi i automjeteve me qira në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit të faturave.

Kontrolli i kualitetit	17.1	Kontrolli i automjeteve se a janë ne përputhshmëri te plote me kushtet e Aneksit 1 dhe ofertës se kontraktuesit janë përgjegjësi e menaxhereve te kontratës nga secili institucion qe e shfrytëzon këtë kontrate.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëve shjes	20.2	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit.  Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve te cilat mund te lindin gjate ekzekutimit se kësaj kontrate dhe se është e mundur te zgjidhet ne mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do te jene personat përgjegjës te Autoritetit Kontraktues - AQP-se, te zyrtareve përgjegjës te Autoriteteve Kontraktuese qe shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës te Furnizuesit
Zgjidhja e mosmarrëve shjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin në Kosovë.

## ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

- Veturat duhet të jenë të reja.
- Timoni duhet të jete në anën e majtë për të gjitha modelet që oferton.
- Dritat e secilit automjet duhet të jene sipas standardeve në Kosove/Evropian
- Ngjyra e veturave mund të jetë - ngjyrë të bardhë apo të zezë apo e hirit metalike. Gjate porosisë së veturës institucionet mund të diskutojnë me OE edhe për ngjyra të tjera dhe nëse është e mundur të sigurohet nga OE. Por nëse nuk arrihet pajtueshmëri atëherë duhet të pranohet njëra nga ngjyrat e lartcekura.
- Secila veturë duhet të posedoj shtrojat edhe të materialit me gomë (dimëror) edhe të materialit mëndafsh (verore).
- Gomat duhet të jenë të sezona në datat që kërkohen me ligj.

Afati i qiramarrjes llogaritet 5 vjet apo 60 muaj nga data e pranimit të automjetit. Afati i liferimit është 100 ditë, nga data e pranimit të veturës (brenda 100 ditëve) do të fillojë llogaritja e kohëzgjatjes së qerasë 60 muaj. Nëse vonohet liferimi më shumë se 100 ditë do të vendosen penaltitë nga institucionet ndërsa llogaritja e kohëzgjatjes së qerasë do të fillojë që nga dita e 101, kjo për arsye se kontrata do të jetë valide për 63 muaj e 10 ditë dhe me rastin e përfundimit të kontratës do të përfundojë edhe qiramarrja e të gjitha veturave.

### Përgjegjësitë e kontraktuesit (operatorit ekonomik që ka nënshkruar kontratë) :

- ✚ Kontraktuesi do të bëjë kontrollimin teknik,
- ✚ Sigurimin.
- ✚ Regjistrimin.
- ✚ Servisimin e rregullt apo sipas nevojave.
- ✚ Furnizimin dhe Ndërrimin e gomave verore dhe dimërore.
- ✚ Mirëmbajtjen, riparimin dhe çdo shpenzim tjetër gjatë periudhës së kontratës.
- ✚ Çdo dëmtim i automjeteve është përgjegjësi e kontraktuesit të rregulloj me shpenzimet e veta. Këtu përfshihen edhe dëmtimet e jashtme për të cilat nuk ka raport të Policisë.
- ✚ Për çdo rast të aksidentit të veturës shoferi duhet të marrë raportin e policisë dhe të ja dorëzojë kontraktuesit në të kundërtën nëse nuk ka raport të policisë dhe dëmtimi nga aksidenti kalon vlerën 350€, do të mbetet në përgjegjësinë e AK-së (apo të detyroj shoferin) pagesa e dëmtimit nëse nuk ka raport të policisë.
- ✚ Sigurimi kasko është në përgjegjësinë e kontraktuesit pra mund të mos i siguroj veturat kasko dhe të bart vet rrezikun.
- ✚ Në rast të defektit të automjetit, kontraktuesi obligohet që brenda periudhës sa me të shkurt të aftësojë apo zëvendësojë automjetin jo më larg se dy ditë pune, kur nevojiten më shumë se dy ditë pune kontraktuesi duhet të ofroj autoritetit një veturë tjetër në përdorim deri sa të rregullohet vetura por jo për periudha më të gjata se 15 ditë pune.
- ✚ Në rast se automjeti është i dëmtuar dhe nuk mund të aftësohet për komunikacion atëherë zëvendësohet prej kontraktuesit me automjet tjetër të tipit të njëjtë dhe jo më të vjetër se viti i veturës së dëmtuar.
- ✚ Kontraktuesi mund të vendosë gomë rezerve me pajisjet përcjellëse dhe në rast të dëmtimit të gomës shoferi i veturës e ndërron gomën dhe e dërgon veturën sa më parë tek kontraktuesi apo kontraktuesi mundet të mos vendosë gomë rezerve dhe ku do që të dëmtohet goma shoferi do të informoj kontraktuesin dhe i njëjti duhet të dërgoj ekipin e tij për ndërrimin e gomës për maksimum 2 orë, kjo pike vendoset në

marrëveshje mes kontraktuesit dhe autoritetit dhe nëse nuk mund të arrijnë marrëveshje vlen zgjidhja të cilën e kërkon autoriteti.

- ✚ Në muajin Tetor dhe Shkurt kontraktuesi do të dërgoj secilit AK orarin se kur do të dërgohen veturat për ndërrimin e gomave në shkresë duhet të ofrohen së paku 3 opsione (3 kohë të terminit – duhet të jenë në ditë pune dhe brenda orarit 08-16) dhe AK do të zgjedh njërën prej terminit që i përshtatet, termini do të caktohet nga 15 Tetor deri me 15 Nëntor për sezonin e dimrit dhe pas 15 Mars deri me 15 Prill për sezonin e verës (në rast se AK vlerëson se për arsye të motit duhet të mbahen gomat e dimrit edhe pas datës 15 Prill do të informoj kontraktuesin dhe terminet mund të shtyhen edhe pas datës 15 Prill. Në rast kur vetura dërgohet në terminin e përcaktuar nga AK sipas opsionet të mësipërm është përgjegjësi e kontraktuesit që të bëjë ndërrimin e gomave për jo më shumë se tri (3) orë, dhe në rast se nuk realizohet nga kontraktuesi kjo gjë AK është e liruar nga pagesa e atij muaji dhe kontraktuesi do të caktoj terminin tjetër (për sezonin e dimrit jo më larg se data 15 nëntor), dhe në rast se kalohet data 15 nëntor do të konsiderohet se kontraktuesi nuk e ka përmbushur kontratën dhe do të shkëputet kontrata duke ju konfiskuar sigurimi i ekzekutimit. Në rast se AK nuk respekton terminin e parapërcaktuar atëherë do të caktohet një termin tjetër por jo më i largët se 15 ditë pune nga terminin që e ka humbur dhe nuk do të ketë penalizime për kontraktuesin.

Gjatë kohëzgjatjes së kontratës kontraktuesi do të ofrojë automjetet në shfrytëzim pa asnjë kufizim për kilometra të kaluara gjatë tërë periudhës së përmendur, pra kilometra të pa kufizuara gjatë periudhës së qiramarrjes.

#### **Përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktues :**

- ✚ Kurdo që të ketë raport të Policisë për aksident do ia dorëzoj kontraktuesit.
- ✚ Nuk lejohet numri i udhëtareve me shumë se siç ceket në librezën e automjetit.
- ✚ Sigurimi i automjetit (TPL+Kasko) për dalje jashtë territorit të RK është përgjegjësi e AK (TPL+ duhet të blihet tek kompania e sigurimeve që është i siguruar automjeti) pra mund të mos i paguaj përmes kontraktuesit dhe rrezikun do ta bart vet, ndërsa nëse kërkon nga kontraktuesi të i siguroj TPL+ atëherë është obligim i kontraktuesit ti siguroj atë sigurim dhe AK do ta paguaj vlerën që ceket në policë së bashku me faturën e muajit vijues.

#### **Shënim:**

- ✚ Në rast të dëmtimi ka rrjedh si pasojë e furnizimit me derivat të automjetit jo adekuat përgjegjësinë e bart pika furnizuese

## ANEKSI 7. LISTA E AUTORITETEVE

<b>Emir i Autoriteteve</b>	<b>Modeli 3</b>
<b>Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Inspektorati i Tregut</b>	5
<b>Thesari i Kosovës</b>	1
<b>Organi Shqyrtues i Prokurimit</b>	1
<b>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</b>	2
<b>Ministria e Shëndetësisë</b>	9
<b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</b>	1
<b>Komuna e Gjakovës</b>	1
<b>Komuna e Podujevës</b>	2
<b>Qendra e Shëndetit Mendor Gjilan</b>	1
<b>Ministria e Infrastrukturës</b>	6
<b>Zyra e Kryeministrit</b>	10
<b>Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm</b>	1
<b>Komuna e Prishtinës</b>	4
<b>Zyra e Presidencës</b>	4
<b>Komuna e Leposaviqit</b>	1
<b>Komuna e Zveçanit</b>	1
<b>Totali</b>	<b>50</b>



Per: AQP – LOT 3  
Prej: Auto Mita sh.p.k.  
Oferta: Oferte per Renault Captur I RI 1.3TCe 160KF Evolution EDC-Automatik – Benzin/ hybrid  
Data: 30.12.2024


RENAULT Captur I RI 2024/2025



Verejtje: Fotot jane informative PER MODELIN FACELIFT 2024/2025 TE CILIN PO E OFROJME.

AUTO MITA  
Distributor gjeneral  
Mugjistralja Prishtinë - Shkup  
10000 Prishtinë  
Nr.F. : 600793724, Nr.B. : 70841932  
Nr.TVSH. : 330159394  
PCB: 111 900 047 500 01 93  
RBKO: 150 108 000 141 55 46  
TEB: 201 100 006 850 10 52

Tel: +381 (0)38 52 00 25  
[www.renault-rks.com](http://www.renault-rks.com)





Pajisje serike


Evolution

### sigurinë dhe drejtimin

Sistemi i asistencës së frenimit emergjent - BAS  
sistem frenimi kundër bllokimit - ABS  
sistem sigurie ESP dhe asistencë për nisjen në kodër HAS  
Sistemi ISOFIX për vendosjen e Ulese të fëmijëve në Uleset e përparme dhe të pasme  
sistemi i thirrjeve emergjente  
frenim automatik emergjent me njohje të këmbësorëve dhe çiklistëve  
Sistemi i kontrollit të lodhjes dhe pavëmendjes së shoferit  
rregullatori dhe kufizuesi i shpejtësisë  
sistem për mbajtjen e mjetit në shiritin e drejtimit dhe parandalimin e daljes së tij nga korsa e drejtimit  
paralajmërim inteligjent i shpejtësisë me njohjen e shenjave të trafikut  
paralajmërim për të ruajtur distancën e sigurisë  
Butoni i konfigurimit të sistemit ADAS  
airbag të përparmë për shoferin dhe pasagjerin  
airbagët anësor përpara dhe perde sigurie në anën s + z  
mundësia e fikjes së airbag-it të pasagjerit të përparmë  
rripat e sigurimit të përparmë të rregullueshëm në lartësi  
rripat e pasmë me trepikësh  
tre mbështetëse koke të pasme të rregullueshme në lartësi  
paralajmërim për rripat e sigurimit të palidhur (në të gjitha sediljet)  
mbyllja, hapja e dritareve të pasme dhe dyerve të pasme  
filtri i ventilimit të ndarjes së pasagjerëve  
Funksioni i modalitetit të drejtimit ECO  
Treguesi i ndryshimit të marsheve (për versionet me transmision manual)  
Pasqyrat e jashtme të rregullueshme elektrike dhe me ngrohje - të palosshme me dorë  
mbyllje qendrore me telekomandë  
ndevoja automatike e dritave të ulëta  
sistemi i kontrollit indirekt të presionit të gomave  
asistencë parkimi në pjesën e pasme  
kamera mbrapa  
2 drita mbrapa

AUTO MITA  
Distributor gjeneral  
Magjistralja Prishtinë - Shkup  
10000 Prishtinë  
Nr.F. : 600793724, Nr.B. : 70841932  
Nr.TVSH. : 330159394  
PCB: 111 900 047 500 01 93  
RBKO: 130 108 000 141 33 46  
TEB: 201 100 006 850 10 52

Tel: +381 (0)38 52 00 25  
[www.renault-rks.com](http://www.renault-rks.com)







drita e tretë e frenave  
çelësi i palosshëm për të zhbllokuar/kyçur dhe ndezur automjetin  
kartë renault pa duar (vlen vetëm për versionin hibrid)  
automjet në përputhje me rregulloren GSR2  
pajisje serike

#### dizajni

mbulesa dekorative rrotash 17" Nymphaea  
trup me një ngjyrë  
fenerët e plotë LED në pjesën e përparme dhe të pasme  
dritat e ditës me nënshkrim drite në "formë diamanti" në parakolp  
treguesit e drejtimit me led në pasqyrat e jashtme  
pasqyrat e jashtme në ngjyrë të zeze  
antenë peshkaqeni  
dorezat e dyerve të jashtme në ngjyrën e trupit  
xhami i lyer  
ndriçimi i ndarjes së pasagjerëve përpara dhe të pasëm

#### rehati

Pasqyrë e brendshme me zbehje manuale  
kondicioner manual  
timoni dhe leva e ndërruesit janë të mbuluara me materiale të buta  
sedilja e shoferit e rregullueshme në lartësi  
tastierë qendrore me mbështetëse krahu  
xhamat e përparmë elektrike - impuls  
xhamat e pasmë elektrike - impuls  
Mbështetësja e palosshme e stollit të pasmë në raportin 1/3 - 2/3  
xhami i pasëm me ngrohje

#### multimediale


Sistemi openR link 10.4" me sistemin e zërit Akramys Classic  
Ekran informacioni 7 inç me instrumente me ngjyra përpara shoferit  
lidhje për shërbimet e lidhura me automjetin

#### aksesorë

komplet për riparimin e gomave

AUTO MITA  
Distributor gjenerali  
Magjistralja Prishtinë - Shkup  
10000 Prishtinë  
Nr.F. : 600793724, Nr.B. : 70841932  
Nr.TVSH. : 330159394  
PCB: 111 900 047 500 01 93  
RIBKO: 150 108 000 141 55 46  
TEB: 201 100 006 850 10 52

Tel: +381 (0)38 52 00 25  
[www.renault-rks.com](http://www.renault-rks.com)





**Paisje shtese mbi pakete:**

Ngjyra sipas kerkeses se autoritetit kontraktues (bardhe ose tjetër)

Goma reserve

Pajisje shtesë : Ndihma e parë, trekëndëshi i sigurisë, zingjirët për borë, dritat rezervë, litari për tërheqje.

**Karakteristikat teknike**

Motori EU6 DTemp	1333 cm <sup>3</sup>
Fuqia kW (KF)	116 /158
Derivatet	Benzin / Hibrid i bute
Shpenzimet e kombinuara L/100km	5.9
Emetimi gazrave CO2 (g/km)	114g/km
Nderruesi	Automatik 7 shpejtesi
Shpejtesia maksimale (km/h)	204 km/h
Numri i cilindrave	4
Çift rrotullues maksimal Nm (m.kg)	260nm ne 1750
Ndertimi motorit ne llojin	Zingjir
0-100 km/h	8.5 sekonda

**Cmimi**

	EUR
Cmimi me TVSH per njesi PER 1 MUAJ	369.00 €
Cmimi me TVSH per 1 veture per 60 muaj	22,140.00 €
Cmimi total per 60 muaj per 50 vetura me TVSH	1,107,000.00€

**1. Afati Liferimit**

100 dite.

**2. Kushtet e pageses**

Sipas marreveshjes

**3. Euro Garancioni**

5 vite

Garancioni eshte valid vetem nese veturat servisohehen ne servis te autorizuar te Renault.

AUTO MITA  
Distributor gjeneral  
Magjistralja Prishtinë - Shkup  
10000 Prishtinë  
Nr.F. : 600793724, Nr.B. : 70841932  
Nr.TVSH. : 330159394  
PCB: 111 900 047 500 01 93  
RBKO: 150 108 000 141 55 46  
TEB: 201 100 006 850 10 52

Tel: +381 (0)38 52 00 25  
www.renault-rks.com



Prokurimi: UA/2016-24-12248-2-1-1

Nr i brendshëm:

Titulli: Vetura me qera për nevojat e institucioneve të Kosovës - Ritender

1	Lot 1 - Modeli 1
2	Lot 2 - Modeli 2
3	Lot 3 - Modeli 3
4	Lot 4 - Modeli 4
5	Lot 5 - Modeli 5

Kodi i tenderit: MITA3012

Data: 30.12.2024

#### Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

---

Nr.	Dokument
1.	1. Aneks 1.pdf
2.	2. ARBK Auto Mita SH.P.K. (E RE).pdf
3.	3. TVSH.pdf
4.	4. Ofertat.pdf
5.	5. LOT 1 Sigurimi.pdf
6.	6. LOT 1 Stepway katalogu final.pdf
7.	7. Lot 2 clio katalogu final.pdf
8.	8. Lot 2 Sigurimi.pdf
9.	9. LOT 3 DHE 4 KATALOGU CAPTUR.pdf
10.	10. Lot 3 Sigurimi tenderit.pdf
11.	10. Lot 3 Sigurimi tenderit.pdf
12.	11. Lot 4 Sigurimi tenderit.pdf
13.	12. LOT 5 duster-katalog.pdf
14.	13. Lot 5 Sigurimi.pdf

#### Përshkrimi i çmimeve

---

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Lot 1 - Modeli 1	Cmimi Lot 1.pdf
2.	Lot 2 - Modeli 2	Cmimi Lot 2.pdf
3.	Lot 3 - Modeli 3	Cmimi Lot 3.pdf
4.	Lot 4 - Modeli 4	Cmimi Lot 4.pdf
5.	Lot 5 - Modeli 5	Cmimi lot 5.pdf

## **AUTORITETI KONTRAKTUES**

---

Agjencia Qendrore e Prokurimit , Ndertesa e Germis, 10000, Prishtinë,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: UA/2016-24-12248-2-1-1

### **OPERATOR EKONOMIK:**

---

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Auto Mita SH.P.K., Magjistranja Prishtine-Shkup, Preoc, -10000, GRACANICA, Kosovë**

E-mail: **pleurat.hashani@automita.com**

Personi kontaktues: **Pleurat Hashani**

Telefoni: **045/500585**

Faxi:

Numri fiskal: **810816481**

**Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):**

# FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

## Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: UA/2016-24-12248-2-1-1

Titulli i kontratës: Vetura me qera për nevojat e institucioneve të Kosovës - Ritender

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

### 3 Lot 3 - Modeli 3

3. Çmimi total i tenderit është:

1,107,000.00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Nr.	Nën-kriteri	Koeficient	Përgjigje EO
1	Çmimi	0.70	1,107,000.00
2	Shpenzime mesatare të karburantit në 100 km ne ciklin e përzier urban dhe nder – urban (kombinuar)	0.30	5.9

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit

kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

#### **Informacion në lidhje me nënkontraktorët**



Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

Numri i Prokurimit: UA/2016-24-12248-2-1-1 – Titulli: Vetura me qera për nevojat e institucioneve të Kosovës - Ritender  
**LISTA E ÇMIMEVE**

**Lot 3- Modeli 3**

NR.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI I QERASË PËR NJË MUAJ ME TVSH	NUMRI I MUAJVE	ÇMIMI I QERASË PËR 72 MUAJ ME TVSH
	B	C	D	E	F	G= D x E x F
1	Vetura - Modeli 3 - Sipas specifikave teknike të paraqitura në Aneksin 1.	copë	50	369.00	60	1,107,000.00
<b>Totali</b>						<b>1,107,000.00</b>

Shënim: Ofertuesit duhet të ofrojnë çmimin e qeras mujore (E7) ndersa vlera e paraqitur tek Totali (G7) duhet të vendoset tek formulari i tenderit. Në çnim përfshihen të gjitha taksat dhe detyrimet sipas Aneksit 1.

Identifikimi i operatorit ekonomik (OE)	
Emri i OE ofertusit:	Auto Mira shpk
Emri dhe mbiemri i përfaqesuesit të ofertuesit:	Pleurat Hashani
Nenshkrimi:	
Data:	30.12.2024
Vula:	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

**ARBK**

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT NË KOSOVË  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA  
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT  
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI  
CERTIFICATE OF REGISTRATION

**810816481**

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

**Auto Mita SH.P.K.**

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

**" Auto Mita " SH.P.K.**

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:  
Poslovni tip:  
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar  
Društvo sa ograničenom odgovornošću  
Limited Liabilities Companies

Adresa:  
Adresa:  
Address:


Rruga Anton Çetta, Nr. 1  
Prishtinë

Data e regjistrimit:  
Datum registracije:  
Date of registration:

30/04/2012

09/11/2021

Data / Date / Datum



*U.P. Haxhiu*  
Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10125575



**Për: AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**  
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

**Në emër të: Auto Mita SHPK, Prishtine, Prishtinë**  
(në vazhdim "operatori ekonomik")

**Titulli i aktivitetit të prokurimit: VETURA ME QERA PËR NEVOJAT E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS -**  
**RITENDER LOT - 3**

Numri i prokurimit: UA/2016-24-12248-2-1-1

## **SIGURIA E EKZEKUTIMIT**

**Garancion**

**Nr.Serik i polices: 31/25**

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;  
DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit;  
DHE NGASE NE jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë-nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **110,700.00 ( një qind e dhjetë mijë e shtatë qind Euro )** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **110,700.00 Euro** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

**Kjo siguri është e vlefshme 1958 ditë prej 30.01.2025 deri më 10.06.2030**

**Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.a.**  
Rruga "2 Korriku", Nr.4, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data: 30.01.2025





Per: Ministria e Financave Punes dhe Transfereve  
Agjencia Qendrore e Prokurimit - AQP  
Perfaqesuar nga: Ardi Mehmeti

Nga: **Auto Mita SHPK NUI 810816481, NRF600793724:**  
Importues ekskluziv per Renault Group ne Kosove  
Perfaqesuar nga: Lisjete Mita ID: 1171435923  
Adrese: Rr. Magjistrale Prishtine – Shkup pn. Fsh. Preoc, Komuna e Gracanices

**Tema:** Autorizim per perfaqesim dhe menaxhim te marrveshjes kontraktuale  
Me titulle: Vetura me qera per nevojat e institucioneve te Kosoves - Ritender Lot 3 me NR te Prokurimit: UA/2016-24-12248-2-1-1 dhe NR te kontrates: UA/2016-24-12248-2-1-1/C640

**Date:** 31.01.2025

**Reference:** 01/AQP/2025

Me kete dokument Auto Mita SHPK me NUI 810816481 autorizon menaxherin e kontrates Alban Mulliqi me ID: 1003294524 qe te marr te gjitha vendimet dhe te nenshkruaj te gjitha dokumentet perkatese ne emer te Auto Mita SHPK-se, lidhur me marrveshjen kontraktuale me:

- Titull: Vetura me qera per nevojat e institucioneve te Kosoves - Ritender Lot 3
- NR te Prokurimit: UA/2016-24-12248-2-1-1 dhe
- NR te kontrates: UA/2016-24-12248-2-1-1/C640

Agjencine Qendrore te Prokurimit.

Alban Mulliqi mund te kontaktohet permes:  
Email Adreses: [alban.mulliqi@automita.com](mailto:alban.mulliqi@automita.com) dhe  
Tel: +383 45 500580.  
Per cdo informate shtese jeni te mireseardhur.

Me respekt,  
Auto Mita  
Lisjete Mita  
1171435923



automita

Distributor gjeneral  
Magjistralja Prishtine - Shkup  
KM. 5, Preoc  
10000 Prishtine  
Nr. U.I.: 810816481  
TEB 201 100 006 850 10 52  
RBKO 150 108 000 141 55 46  
PCB 111 900 047 500 01 93  
BKT 190 158 581 303 1114  
NLB 170 100 101 227 08 74  
BEK 1401 0000 1364 3326  
Ziraat 22001301 002513 84

Tel: +383 (0)38 600 045  
[www.renault-rks.com](http://www.renault-rks.com)